

HAPËSIRAT NDËRKUFITARE SHQIPTARE MUNDËSI BASHKËPUNIMI DHE INTEGRIMI NË RAJON

Dhimitër DOKA

Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

E-mail: *dhdoka@yahoo.com*

PËRMBLEDHJE

Bashkëpunimi ndërkufitar përbën një dukuri të vjetër për Evropën, por të re për Shqipërinë. Mund të jepen shumë shembuj të bashkëpunimi të hershëm në këtë drejtim, veçanërisht midis vendeve të Evropës Perëndimore, si p.sh. midis Gjermanisë dhe Francës, Gjermanisë dhe Zvicrës, Austrisë, Italisë dhe Zvicrës etj. Pas rënies së kufijve të Lindjes ky bashkëpunim u zgjerua edhe me vendet e ish-bllokut Lindor, si midis Gjermanisë dhe Çekisë, Gjermanisë dhe Polonisë etj. Në rastin e Shqipërisë për një bashkëpunim të tillë nuk mund të bëhej fjalë deri në vitin 1990, kur kufiri ishte një barrierë e pakalueshme. Në këto kushte zonat kufitare nuk kishin ndonjë rëndësi zhvillimi, madje ishin edhe më të izoluar se pjesët e tjera të vendit. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar për Shqipërinë dhe rajonin tonë në përgjithësi do të fillonte të kishte kuptim dhe të rritej vetëm me prishjen e kuptimit të mëparshëm të kufijve pas vitit 1990 e veçanërisht pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999. Tashmë ky bashkëpunim vlerësohet si një mundësi dhe alternative mjaft e mirë zhvillimi dhe integrimi rajonal. Bazuar në rëndësinë që paraqet bashkëpunimi ndërkufitar në zhvillimin dhe integrimin e vendeve dhe rajoneve të ndryshme, lindi edhe ideja për kryerjen e një studimi të përbashkët me studentët dhe pedagogët gjeografë nga Uni-

versiteti i Tiranës dhe ai i Bambergut, Gjermani, në zonat kufitare të Shqipërisë me vendet përçark. Zonat kufitare të Shqipërisë kanë specifikat e tyre, të cilat do të trajtohen në këtë punim.

Fjalë kyçe: Bashkëpunimi ndërkufitar, integrimi rajonal, marrëdhëniet ndërkufitare të Shqipërisë me fqinjët.

Key words: Interboundary collaboration, regional integration, interboundary relations of Albania with its neighbours.

I. HYRJE

Hapësirat ndërkufitare nuk përbëjnë një problematikë të re. Ato njihen që me krijimin e shteteve të reja në shek. XIX. Megjithëse për hapësirat ndërkufitare, apo eurorajonet siç njihen sot në Europë, nuk ka një përcaktim të qartë, ato konsiderohen si territore të kufizuara midis shteteve në kufi me problematika, qëllime e synime perspektive të caktuara, hapësira të rëndësishme bashkëpunimi midis popujve dhe shteteve në zonat e tyre ndërkufitare.

Bazuar në literaturën rreth kësaj problematike, ideja dhe bashkëpunimi në zona ndërkufitare ka ardhur më së shumti nga vetë popullsitë e këtyre hapësirave se sa nga qeveritë e vendeve përkatëse. Rregjimet dhe pushtetet kanë mbajtur qëndrime të ndryshme ndaj këtyre zonave, në

varësi të situatave e ngjarjeve historike e politike ndërkombëtare e rajonale. Sot, në përgjithsi, në kushtet e reja gjeopolitike, qeveritë kontribuojnë në krijimin e kushteve për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkohë që më të interesuar mbeten popullsitë lokale të tyre.


Në pjesën më të madhe të rasteve, bashkëpunimi ndërkufitar përfshin ndërveprim të gjerë ose sektorial, si: ekonomik, kulturor, social, politik etj. Në këtë kuadër mund të përfshihen edhe çështje të veçanta, si p.sh.: për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie më të mira në të gjitha fushat e jetës dhe nivelet midis qytetarëve dhe autoriteteve (rasti i eurorajonit midis dy provincave gjermane e holandeze, me sipërfaqe 13000 km² dhe rreth 3,2 milionë banorë, krijuar si nismë që në vitin 1958); apo për qëllime të mobilitetit të punësimit në rajonet kufitare; për qëllime turistike; mbrojtjes së mjedisit; forcimin e bashkëpunimit të institucioneve lokale e rajonale; shkëmbime informacioni teknologjik, të të rinjve; veprimtari të përbashkëta etj.

Në këto bashkëpunime janë përfshirë veçanërisht popullsitë lokale në të dy anët e kufirit, grupe të veçanta të interesit, institucione të zgjedhura dhe ekzekutive (bashki, komuna, distrikte etj.), madje deri në nivele fshati, qyteti, apo grupe fetare, gjuhësore, kulturore, sportive, specialistësh etj.

Në mënyrë më të organizuar dhe me qëllime të qarta, eurorajonet hasen veçanërisht në vendet e Europës Perëndimore, duke filluar sidomos në vitet '50 të shek. XX e në vazhdim. Shembuj të tyre janë të shumtë e mund të përmendim ato midis Gjermanisë e Hollandës, Zvicrës, Austrisë, Danimarkës, Francës, midis Italisë dhe Francës, Zvicrës, Austrisë, etj.

Mbarimi i Luftës së Ftohtë pas vitit 1990 dhe rënia e barrierave politike si dhe proceset integruuese që i shoqëruan ato, krijuan kushte të reja e të favorshme për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht me vendet e ish-blokut komunist. Kështu eurorajonet gjermane u shtrinë drejt Polonisë dhe Çekisë, ndërsa ato italiane drejt Sllovenisë. Ky bashkëpunim u zgjerua me problematika të reja për vetë specifikat që paraqesin ish-vendet e blokut komunist, si: zhvillimi i tyre dobët ekonomik; struktura e ndryshme ekono-

mike; infrastruktura e dobët; migrimet e shumta të popullsisë deri në deformime të strukturave demografike, mungesa e popullsisë aktive; sistemet e dobëta politike dhe ligjore; mungesa e strategjive dhe politikave për zhvillimet ndërkufitare, lokale e rajonale; probleme të trafikeve ilegale të karakterit ekonomik, njerëzor etj.,



Trajtimi gjeografik i këtyre problemeve është i rëndësishëm për vetë natyrën e trajtimit hapësinor kompleks dhe perspektiv të tyre. Në disa vende ky trajtim është ngritur deri në disiplinë të veçantë me emrin "Gjeografi e vendeve kufitare", e është si lëndë mësimore në arsimin e lartë dhe formimin akademik.

Për Shqipërinë, trajtimi i zonave ndërkufitare mund të cilësohet sa i vjetër aq edhe i ri. Ky trajtim ka shumë rëndësi, jo vetëm për të shkuarën, por edhe për të sotmen dhe sidomos për të ardhmen. Analiza e tyre në kontekstin e eurorajoneve do t'i shërbente jo vetëm zhvillimit më të mirë e më të shpejtë, por edhe perspektivës europiane si një aspiratë kryesore e vendit tonë.

Në trajtimin e zonave ndërkufitare në konceptin e eurorajoneve duhet të kihen parasysh disa veçori historiko-territoriale të popullsisë sonë si:

- Bashkëpunimi në zonat tona ndërkufitare ka qenë dhe është midis shqiptarëve. Kufiri konsiderohet si kufi ndërshtetë me lidhje të forta shpirtërore dhe bashkëpunim të hershëm ekonomiko-shoqëror.

- Ndarja e padrejtë kufitare e territoreve tona ka shkaktuar ngjarje të mëdha historike, deri luftra rajonale e lokale. Këto luftra kanë penguar zhvillimin, rrjedhën normale të ngjarjeve ballkanike dhe integrimin midis popujve. Prandaj duhet të merren parasysh edhe disa faktorë historikë.

- Faktorët historikë dhe vështirësitë e zhvillimit të sotëm kanë krijuar disa probleme politike midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale, si dhe mosbesime reciproke, hezitime e diferencime.

- Prania e minoriteteve në zonat ndërkufitare shërben si urë lidhjeje dhe bashkëpunimi.

- Pasuritë natyrore, në veçanti deti, lumi i Bunës dhe liqeni i Shkodrës, kanë qenë dhe janë mjedise të rëndësishme të përbashkëta për bashkëpunim, duke i dhënë nxitje disa marrëveshjeve dhe veprime të përbashkëta.

- Në të dy anët e kufirit ekziston aspirata e përbashkët e integrimin europian, duke përbërë një predispozitë pozitive për bashkëpunimin në perspektive, për të harruar të kaluarën, korrigjuar atë dhe si mundësi zhvillimi të përbashkët.

II. METODOLOGJIA, METODAT E PUNËS DHE ORGANIZIMI I STUDIMIT

Realizimi i këtij studimi është pjesë e punës së përbashkët të një projekti shqiptaro-gjerman mbi zonat kufitare, ku morën pjesë studiues dhe studentë nga Shqipëria, Gjermania, Kosova dhe Mali i Zi. Duke u nisur nga rëndësia dhe problematika e zonave ndërkufitare, veçanërisht për Shqipërinë, si dhe përvoja e disa bashkëpunimeve të tjera me palën gjermane, vëmendja u përqendrua në shembuj të analizës së krahasuar të eurozonave (eurorajoneve), të kaluara dhe të sotme midis Gjermanisë me Poloninë e Çekinë. Realizimi i këtij studimi u krye në disa faza:

Faza përgatitore

- U kryen seminare përgatitëse rreth kësaj problematike;
- U njohën dhe u studiuan disa zona tipike të

bashkëpunimit ndërkufitar gjerman, përvoja dhe vizita në to, literatura përkatëse etj.;

- U ngritën rrjetet e bashkëpunimit dhe grupet e punës;

- U përzgjedhën zonat e studimit.

Organizimi i punës në terren

- U përgatitën informacione, statistika e material dokumentar për punën në zonat përkatëse;

- U ndanë grupet e punës sipas zonave;

- U përgatitën pyetësorët rreth kësaj teme;

- U kryen vrojtimet dhe intervistat në terren;

- U dokumentua gjithë puna në terren.



Harta e zonave kufitare të Shqipërisë me vendet fqinjë

Puna kamerale (hartimi i studimit)

- U diskutua në mënyrë të përbashkët puna dhe materialet në dy fazat e para;

- U formulua struktura e studimit në grupin e punës;

- U kryen plotësime me material hartografik e informacione të tjera;

- U ra dakort për përfundimet dhe materialin e analizuar;
- U hartua materiali studimor dhe u diskutua përfundimisht për të.

III. REZULTATET E PUNES NE TERREN

Zonat kufitare të Shqipërisë kanë specifikat e tyre, ku veçojmë:

- Pjesa më e madhe mbeten zona ndërshqiptare;
- Kushte të vështira të relievit dhe infrastrukturës e dobët;
- Disnivele të dukshme në zhvillimin socio-ekonomik.
- Megjithë lehtësirat, kufiri mbetet përsëri një pengesë për zona të veçanta, sidomos me Greqinë;
- Në krahasim me të kaluarën, janë shtuar ndjeshëm komunikimet, aktivitetet, bizneset në zonat ndërkufitare;
- Ekziston optimizëm dhe mundësira për një zhvillim më të mirë ndërkufitar.

IV. TIPARE DALLUESE NË ZHVILLIMIN E ZONAVE KUFITARE TË SHQIPËRISË

Përparësitë që ofron qenia zonë kufitare:

- Gjatësia e madhe e kufirit tokësor me Greqinë, Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi;
- Kufi ndërshqiptar me lidhje të forta socio-ekonomike dhe shpirtërore;
- Lidhjet e veçanta që ka krijuar historia e përbashkët dhe ngjarjet e veçanta (rasti i Kosovës, 1999);
- Prania e minoriteteve si urë lidhëse dhe bashkëpunimi;
- Potenciale të rëndësishme natyrore dhe humane në të dy anët e kufirit.

Problemet që vështirësojnë zhvillimin ndërkufitar:

- Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik në të dy anët e kufirit (përveç Greqisë);
- Problemet e tranzicionit: rënie ekonomike, papunësia mbi 30%, te ardhurat më të ulëta se mesatarja e vendit (për Kukësin 60-70 lekë në ditë); mbi 40% e familjeve me ndihmë sociale, biznese të vogla e të mesme sa për të mbijetuar;

- Në Kosovë e Maqedoni gjendja ekonomike gjithashtu e vështirë, mungesë stabiliteti etj.;
- Greqia ende e rezervuar për bashkëpunimin ndërkufitar;
- Gjendja veçanërisht e vështirë e infrastrukturës në zonat ndërkufitare, vetëm lidhje rrugore dhe me vështirësi të mëdha;
- Kalimet doganore të dominura nga importet;
- Reliev i thyer e shpesh tepër malor
- Ndarja gati 50 vjeçare e shqiptarëve nga të dy anët e kufirit me ndikim në një zhvillim, mentalitet, traditë e besim të ndryshëm.;
- Vështirësitë që krijon legjislacioni në vendet përkatëse;
- Kualifikimi i ulët i administratës për të zgjidhur problemet;
- Roli pozitiv i doganave dhe zonave kufitare zbehet shpesh nga veprimet ilegale, evazioni fiskal, tregëtia e fshehtë etj.

V. BASHKËPUNIMI I DERISOTËM POZITIV DHE PREMTUES

Kjo gjë shprehet në:

- Qarkullimin e madh të njerëzve dhe mallrave. Aq e fuqishme është bërë kjo lidhje sa banorët në zonat e veçanta e gjejnë veten më të lidhur me zonën përtej kufirit (Prespa, Shishtavec, Kukës-Has-Tropojë, komunat në kufi me Malin e Zi etj.);
- Tregtinë, kryesisht import produktesh ushqimore, bagëti, karburant etj., veçanërisht me Greqinë, Prizrenin, Gjakovën etj.;
- Punesimin në vendet kufitare: Greqi, Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi. Kryesisht në ndërtim, bujqësi, tregëti etj.
- Aktivitetet e përbashkëta ekonomike, sociale, sportive etj.;
- Arsimimin në pjesën kosovare, maqedonase, greke etj.;
- Shërbimin shëndetsor ndërkufitar;
- Lidhjet martesore nga të dy anët e kufirit (p.sh. 40 raste vetëm nga Kruma me Kosovën);
- Festat e përbashkëta kombëtare dhe fetare.

VI. SHEMBUJ KONKRETË TË BASHKËVEPRIMIT NDËRKUFITAR

- Kapshtica: qendra më e rëndësishme e kalimit kufitar në pjesën Juglindore të Shqipërisë;

- Prespa: bashkëpunim intensiv individual dhe lokal ndërkufitar;

- Pogradeci: shembuj të shumtë bashkëpunimi me pjesën maqedonase;

- Shishtavec: fati i tij lidhet me kufirin;

- Morini: vendi që i jep tonin krejt bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën (qarkullim i madh mallrash e njerëzish nga të dy anët; vetëm gjatë verës mbi 100.000 kalime drejt Shqipërisë dhe 70.000 kthime; takim mujor i doganierëve dhe policisë së dy anëve; kërkohej heqje e taksave doganore për prodhimet vendase);

- Kruma: bashkëpunimi kryesisht individual dhe i paorganizuar;

- Tropoja dhe Gjakova: funksionojnë tashmë si një njësi e vetme;

- Hani i Hotit dhe Muriqani: artieret kryesore të lidhjeve me Malin e Zi. Kufizimi i Muriqanit vetëm për kalim njerëzish.

VII. SHEMBUJ BASHKËPUNIMI

NGA ANA TJETËR E KUFIRIT

- Ideja e mirëpritur e Eurorajonit midis Korçës, Follorinës dhe Bitolës. Investimet e shumta greke në zonën e Korçës;

- Bashkëpunimi në nivel komunal midis Maqedonisë dhe Shqipërisë (Prespa dhe Pogradeci);

- Dragashi: kufiri ka mbetur formal. Lidhje të ngushta midis së njëjtës popullsie. Vështirësi infrastrukturore të bashkëpunimit kufitar;

- Prizreni: qendra më e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën; treg blerjeje për shumë shqiptarë nga Kukësi; punësim, arsimim dhe jetesë për persona dhe familje nga Shqipëria; bashkëpunim ndërinstytucional i dobët; lidhje e vështirë rrugore me Tiranën, gjë që favorizon lidhjen me Maqedoninë;

- Gjakova: lidhje të hershme dhe të forta midis dy anëve; bashkëpunim ndërkufitar më i organizuar; projekte dhe shoqata për bashkëpunim

ndërkufitar; 52 km kufi, 2 pika doganore legale dhe 3 ilegale ku kalojnë 200-300 persona në ditë, 90% e produkteve ushqimore Tropoja i merr në Gjakovë, rreth 100 punëtorë nga Tropoja punojnë atje dhe 80 nxënës mësojnë në Gjakovë etj.;

- Ulqini dhe rrethinat e tij: bashkëpunimi me Shqipërinë shumë i dëshiruar dhe potencial i rëndësishëm për të ardhmen.

VIII. SFIDAT PËR TË ARDHMEN

- Kudo në zonat ndërkufitare ekziston dëshira dhe optimizmi për një bashkëpunim më të mirë në të ardhmen;

- Infrastruktura është faktor vendimtar për zgjerimin e lidhjeve;

- Arteriet e pritshme rrugore si Koridori 8, rruga Durrës-Kukës-Prishtinë, Tiranë-Peshkopi-Dibër, Gjakovë-Alpe Shëngjin, si dhe ndërtimi i aeroportit të Kukësit

- Shpresat dhe ëndrrat për një zhvillim më të mirë ndërshtetëror dhe rajonal;

- Bashkëpunimi ndërkufitar pararendës i sigurisë, integritetit rajonal dhe evropian.

BIBLIOGRAFIA

1. *Almanak i bashkive dhe komunave të Shqipërisë*, Tiranë 2005 (Botim i Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit).

2. AXHEMI, S. (Tiranë 2005). *Studime Gjeografike nr. 15 "Aspekte ekonomike, sociale e demografike të territorit kufitar të rajonit të Shkodrës"*.

3. *Euregio Egrensis and PAIJAT – HAMEEN LIITTO (a trans-National Network)*. Marktredwitz, Gjermani, 1998.

4. *Instat dhe të dhëna e treguesve statistikorë nga institucionet rajonale e lokale përkatëse*, 2005.

5. Instituti për hapësirën dhe ekologjinë - Dresden (Botime mbi zonat kufitare dhe studime ndëroeuropiane, 2005).

6. WARNBACHER, P. *Euregios along German borders*, Bamberg, Gjermani 2005.

7. <http://www.euregio.de,6.8.2005>,

<http://europa.eu.int,6.8.2005>,

<http://www.aebr.net,6.8.2005>